

VENDIM
Nr. 484, datë 26.6.2026

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 980, DATË 2.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIMIT, ZBATIMIT TË PUNIMEVE, MBIKËQYRJES
DHE KOLAUDIMIT TË QENDRËS SË SHËRBIMEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
MJETEVE TË TRANSPORTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3/2, të vendimit nr. 980, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3/3, me këtë përmbajtje:

“3/3. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, për financimin e projektimit, të zbatimit të punimeve, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, të jetë në masën 158 747 529 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi